



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:290051

Datë: 13.03.2025

Numri i dokumentit: 06987057

C.nr.4455/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.M. nga fshati B. Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Muhamet Ibraj, avokat në Pejë, kundër të paditurës M e P të B.- Drejtoria e P. së Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike kompensim për pune gjate vikendeve, vlera e kontestit 439.55 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik me datë 05.03.2025, në prezencën e të autorizuarit të paditësit e në mungesë të palës së paditur, kurse me datën 13.03.2025 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit V. M. nga fshati B. Komuna Pejë.
- II. DETYROHET e paditura M e P të B.- Drejtoria e P. së Kosovës në Prishtinë, që paditësit V. M. nga fshati B. Komuna Pejë, në emër të kompensimit shtesë 50 % ne ore për pune gjate fundjavës, për vitin 2022 për 376 orë pune në vikende (47 ditë), të ia paguajë shumën prej 439.55 euro , dhe atë:
  - Në emër të pagesës neto në shumë prej: 357.92 euro të cilat paguhen në llogarinë e paditësit,
  - Në emër të kontributeve për trustin pensional në shumë totale prej: 41.86 euro, ku 20.93 euro do të paguhen si kontribut i punëdhënësit (paditurës) të llogaritur 5%, kurse 20.93 euro do të paguhen si kontribut i punëmarrësit (paditësit) të llogaritur 5%, e të cilat do të paguhen në llogarinë e paditësit në Trustin Pensional – Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës,
  - Në emër të tatimit në pagë në shumë: 39.77euro të cilat do të paguhen si tatim në burim në ATK,

e të gjitha këto me kamatës ligjore prej 8% në vit e cila do të rrjedhë për pagesë nga data 20.12.2023 (datë e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

- III. DETYROHET e paditura M e P të B.- Drejtoria e P. së Kosovës në Prishtinë, që paditësit V. M. nga fshati B. Komuna Pejë, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të ia paguajë shumën në lartësi prej 401 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

#### A r s y e t i m

- I. Historiku i procedurës:

Paditësi V. M. nga fshati B. Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Muhamet Ibraj, avokat në Pejë, kundër të paditurës M e P të B.- Drejtoria e P. së Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, ka ngritur padi me bazë juridike kompensim për pune gjatë vikendeve, vlera e kontestit 439.55 euro.

Pala paditëse fillimisht me padi inicuese ka kërkuar kompensim për pune gjatë vikendeve për vitet 2022 dhe 2023, mirëpo i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë dhe ka kërkuar kompensim vetëm sa i përket vitit 2022 dhe 2023, ashtu që gjykata në seancën e datës 05.03.2025 me aktvendim procedurale e ka lejuar precizimi e kërkesëpadiisë ne aspektin objektiv vetëm sa i përket kërkesës për kompensim për orët në vikende për vitet 2021, 2022 dhe 2023 e sipas parashtresës së datës 27.01.2025.

- II. Pretendimet e ndërgjyqësve

Paditësi përmes të autorizuarit të saj në padi ka deklaruar se paditësi punon në Policin e Kosovës-S. Policor në Pejë, dhe asnjëherë nuk është paguar për punën e tij gjatë ditëve te fundjavës edhe pse kjo e drejtë i takon duke u bazuar ne ligjet e poshtë shënuara: Me ligjin e punës neni 56 par. 2.pika 2.5 I. punësuarit i takon paga shtesë ne përqindje të pagës bazë, si me poshtë: 50 % përqindje ne orë për punë gjatë fundjavës. Po ashtu me Ligjin e P., neni 47 Paga dhe kompensimi për personelin policor 2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor ne mënyre të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione. Pagesat e tilla shtese bazohen ne faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohet vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nen stresë, punën jashtë

orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta. Poashtu me udhëzimin administrativ Nr. 02/2018 neni.62. pika 1.5 “ Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si me poshtë: 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës. Policia e Kosovës asnjëherë nuk e ka kompensuar paditësin për 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës. Paditësi është i punësuar me orar të plotë tek e paditura që nga data 16.01.2006e me tutje me page mujore prej 652.02 euro. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se po ashtu bazë juridike që mbështesin padinë janë dhe oraret lidhshmërisë të cilat vërtetojnë ditën që paditëse ka punuar për vikende dhe vërtetimi i punësimit i cili dokumenton pagën e paditësit që janë të nxjerra nga sistemi kompjuterik “P.”. Ky sistem është bazë e të dhënave dhe është dosje për secilin zyrtar policorë .Zyrtari P.mund të kyçet në këtë sistem përmes email-it zyrtar duke përdorë edhe passëord-in e vet. Zyrtar të policorë nuk mund të bartin të dhëna për vete në këtë sistem por këtë e bënë menaxheri i vijës së parë. Andaj referuar udhëzimit administrativ mbi krijimin e marrëdhënies e punës në P. e Kosovës 02/2023 neni 5 par 2 përcakton qartë që dokumentet nga sistemi elektronik P. janë dokumente zyrtare dhe të besueshme. E paditura në përgjigje në padi është përpjekur të arsyetohet se paditësit nuk i takon ky kompensim ngase i njëjti punën në orarin qarkullues të rregullt por këto pretendime janë të pa qëndrueshme ngase edhe zyra ligjore e P. së Kosovës në një dokument të dt.19.12.2016 pohon se kjo e drejtë ju takon atyre që punojnë gjatë vikendeve, andaj duke u bazuar në këto rrethana konsiderojë se është bërë fakt i pakontestueshëm se Policia organizon orarin 24/7 dhe po ashtu është bërë fakt i pa kontestueshëm se paditësi nuk është paguar për 50% shtesë për punën gjatë vikendeve. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesë së saj pasi që gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor dhe pas administrimit të provave siç janë lista e orareve të punës gjatë vikendeve e veçanti konstatimi dhe mendimi të dhënë nga eksperti në ekspertizë financiare është vërtetuar që paditësit punon tek e paditura dhe se të njëjtit kanë punuar edhe gjatë ditëve të vikendeve. Edhe në përgjigjen në padi që ka dhënë e paditura nuk i ka kundërshtuar faktet kryesore se paditësit ka punuar tek e paditura , ka punuar gjatë ditëve të vikendeve dhe për këtë nuk është kompensuar as me pushim e as me të holla . E drejta për tu paguar me 50 % shtesë pagë për orë për punë gjatë vikendeve rrjedhë nga Ligji i Punës neni 56 par 2.5 i cili qartë përcakton se të punësuarve e që punojnë ditët e vikendeve e ju takon shtesë pagë 50 % për orë mbi pagën bazë. Kjo e drejtë parashihet edhe me Ligjin e P. neni 47 dhe me udhëzimet administrative mbi krijimin e marrëdhënies së punës së P. së Kosovës udhëzim numër 02/2018 neni 62 pika 1.5, udhëzimi administrativ numër 01/2031 neni 65 pika 1.5 dhe udhëzimi

administrative numër 02-2023 neni 62 pika 1.5 të gjitha këto udhëzime përcaktojnë se te të punësuarave që punojnë gjatë vikendeve ju takon shtesa në pagë 50% për punë në orë gjatë vikendeve. Duke u bazuar në të cekurat më lartë gjykatës i propozoj që ta aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe precizimin e dt.27.01.2025 të precizuar drejtë për së drejti në këtë seancë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar me parashtrës të specifikuar me parashtrësë në shumë prej 495 euro.

E paditura përmes përfaqësueses të saj, pranë kësaj gjykate ka paraqitur përgjigje në padi duke e kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar padinë e paditësit, pasi që bazuar në Udhëzimin Administrative Nr.02/2023 mbi marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, si dhe bazuar në Ligjin e Punës 03/ L-212, neni 24 (ndarja dhe ndryshimi i orarit të punës), pika 1, 2 dhe 3, orari i punës përfshin: orarin administrativ 08:00-16:00 dhe orarin me ndërrime dhe orarin e veçantë, pra Stafi në P. Kufitare punon me dy (2) orare: 1. Orarin administrativ, në të cilën përfshihen: stafi menaxherial, njësitë relevante në nivel qendror dhe lokal, komandant e Stacioneve, dhe shefat e operativës të SPK dhe SPMK dhe 2. Orarin katër ndërrimesh 12 orësh, me fillim 08:00 - 20:00 dhe 20:00 - 08:00, punojnë zyrtarët policorë, udhëheqësit e ndërrimeve në SPK dhe SPMK . Ky orar (2) është qarkullues, 2 ditë punë nga 12 orë dhe 2 ditë pushim, orar i cili është i Aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i P. dhe orar i inkorporuar në sistemin P.. Ky orar nuk ndërlidhet domosdoshmërisht me fund javë, pasi që koha e akumuluar e pushimit javor shfrytëzohet në mënyrë qarkulluese në varësi të orarit mujor të punës. Të gjitha oraret e punës gjenerohen në sistemin P. duke përfshirë kalkulimin e orëve të punës për ditët e festave dhe ndërrimet e natës, por sistemi nuk e bën kalkulimin për ditët e fund javës pasi që orari është qarkullues dhe pushimi javor shfrytëzohet në vartësi të orarit të punës, pasi që ky orar është i planifikuar si orar i rregullt Operativ për njësitë Kufitare që veprojnë 24/7, ndërsa nga ana e mbikëqyrësve bëhet vetëm konfirmimi i vijueshmërisë në detyrë në sistemin P. dhe të gjitha benefitet si ndërrimet e natës dhe puna në festat zyrtare do të ju kalkulojnë me automatizëm nga sistemi P. dhe mjetet ju dalin në pagë. Ndërsa në rastet e angazhimit përtej orarit të rregullt të punës, zyrtarëve ju evidentohen orët shtesë të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në përputhje me PSO-në nr.refer.-071 DP-19 datës 22.11.2022 që rregullon këtë fushë. Pas evidentimit në sistemin PRMS bëhet kompensimi financiar. Sipas evidencave, administrimit të orareve të vijueshmërisë në punë, zyrtarëve policorë nuk ju janë akumuluar numri i pretenduar i orëve shtesë përtej orarit të rregullt. Ndërsa për të gjitha orët e punës në të cilat zyrtarët policorë janë të

angazhuar përtej orarit të rregullt, regjistrohen, aprovohen, administrohen në sistem nga mbikëqyrësit dhe paguhen në baza mujore. Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë e duke pasur parasysh që orët e punës së fundjavave që paditësi pretendon se duhet të i kompensohet, në fakt janë orë të punës në kuadër të orarit të rregullt të punës së tij. E autorizuar e të paditurës nëpërmes parashtrese se datës 28.02.2025 ka theksuar se mbetemi në tërësi pranë kundërshtimeve të dhëna në përgjigje në padi duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, dhe ka potencuar se bazuar në nenin 87 afati i parashkrimit gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës” të Ligji Nr. 03/L-212 të Punës, andaj duke u bazuar në rrethanat e lartcekura e autorizuar e të paditurës i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit të refuzojnë në tërësi si të pa bazuar. Gjykata gjatë seancave të shqyrtimit kryesor ka konstatuar se pala e paditur nuk është prezentë, dhe ftesat për seanca i ka pranuar, ndërsa mungesat i ka arsyetuar me parashtrese duke i propozuar gjykatës që të mbaje shqyrtimin kryesor në mungesës të saj dhe pas kësaj Gjykata konform nenit 423 par.4 të LPK-së ka vendosur që seancat të mbahen në mungesë të palës së paditur. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### III. Provat e administruara

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, sipas propozimit të palëve, në procedurën e të provuarit, i ka administruar këto prova: Vërtetimi i punësimit i dt.07.12.2023 me numër 05/3/SRR-BNJ- P/951/2023, raporti i për vitin 2022 për V. M., interpretimi ligjor i dt. 19.12.2016 i P. së Kosovës, ekspertiza financiare e dt.16.12.2024 e përpiluar nga eksperti Muhamet Muriqi.

### IV. Vlerësimi faktik dhe juridik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese se paditësi ka themeluar marrëdhënie punë me të paditurën P. e Kosovës me orar të plotë, fakt ky i vërtetuar përmes vërtetimi punësimi për paditësin i datës Vërtetimi i punësimit i dt.07.12.2023 me numër 05/3/SRR-BNJ- P/951/2023,, e lëshuar nga M e P të B.– Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e P..

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqësve ishte sa a i takon apo jo paditësit kompensimi shtesë 50 % në ore për pune gjate fundjavës, për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Nga Raporti i vijueshmërisë/pushimeve të lëshuar nga M e P të B.– Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e P. për paditësin V. M., gjykata ka vërtetuar faktet si në vijim: Paditësi ditë të punës për fundjave gjate vitit 2022 i ka gjithsej 47 dite.

Bazuar në nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që përcakton se, *Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”,* andaj gjykata i mori të besueshme provat e bashkëngjitura nga paditësi, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga organi shtetëror dhe nga vetë e paditura, kurse kjo e fundit nuk ka dorëzuar ndonjë provë me të cilën vërtetohet e kundërta.

Lidhur me lartësinë e kontestit, gjykata me propozim të palës paditëse ka nxjerrë ekspertizë financiare, të cilën e ka përpiluar eksperti Muhamet Muriqi i dhe në gjykatë e ka dorëzuar me datë 16.12.2024.

Eksperti financiar, në aktin e tij ekspertues, duke iu përmbajtur detyrave të dhëna nga ana e gjykatës, ekspertizën e ka punuar duke e llogaritur kompensimi shtesë 50 % në ore për pune gjate fundjavës për paditësin për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2023 për secilin vit veç e veç. Përmes kësaj ekspertize, gjykata ka vërtetuar se paditësi në vitin 2022 ka pasë gjithsej 47 ditë punë në vikende apo 376 orë, ashtu që konstatimi i tij përfundimtarë është ne shumen prej 439.55 euro paga shtese për ditët e fundjavës në neto, për kontribut pensional për ditët e fundjavës ne shumen prej 41.86 euro, dhe ne emër te tatimin ne page për ditët e fundjavës ne shumen prej 39.77 euro e në total në shumën prej 439.55 euro në bruto. Paditësi pra, si punëtor me ndërrime, ka punuar edhe gjatë ditëve të fundjavës varësisht prej kohës së punës, me ç’ rast është vërtetuar numri i orëve të punës të fundjavës për paditësin, është bërë përlllogaritja e kompensimit shtesë të pagës në shkallë prej 50% të pagës e përlllogaritur për orët shtesë, në mbështetje të pagës bazë, përfshirë edhe rritjen e pagave për periudhat përkatëse e për punën në vikende. Përlllogaritja e pagës shtesë është bërë në shumën bruto, nga shuma bruto është zbritur kontributi pensional si

dhe tatimi në burim. Pra, eksperti në formën e shkruar dhe tabelore ka shpjeguar periudhën kohore për diferencën e pagave shtesë të papaguara, pagën neto, pagën bruto, kontributin pensional, tatimin në burim, të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishme, me të dhënat tjera të detajizuara, si në ekspertizën e dt.16.12.2024.

Gjykata ka ftuar për sqarime ekspertin Muhamet Muriqi, i cili në seancën e datës 05.03.2025, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kësaj ekspertizë, dhe nuk ka pasur çka te shtojë lidhur me ekspertizën e lartcekur. Gjykata i ka falur në tërësi besimin kësaj ekspertize, ngase e njëjta është punuar në bazë të njohurive që ka eksperti dhe në harmoni me ato prova që ka pasur para vetes.

Fillimisht, gjykata thekson se në këtë çështje si ligj i aplikueshëm është Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, i cili është në fuqi nga data 16.12.2010. Sipas këtij ligji, në nenin 56, të Ligjit të Punës, lidhur me Pune shtese është përcaktuar 1. *“Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”*. 2. *“Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës”*. 3. *“Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra tjetrën”*. 4. *“I punësuari mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t’i bëhet me ditë pushimi”*; 5. *“Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të kompanisë”, si dhe në dispozitën e nenit 47 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 Për P. ku përcaktohet se “ Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nën stres, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta”*.

Kompensimi i punës shtese gjate fundjavës ka baze edhe ne nenin 64 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 Mbi Marrëdhënien e Punës në P. e Kosovës, ku theksohet *“ Ditët e punës që kompensohen 1. Për ditët e punuara gjatë festave, pushimeve, punës jashtë orarit, paraqitjes në gjyq, stërvitjeve të obligueshme dhe për kryerjen e detyrave speciale përtej orarit të zakonshëm*

*të punës, bëhet kompensimi në ditë të lira apo në pagë. Të punësuarit i takon kompensimi me ditë të lira apo paga shtesë në përqindje të mëditjes, si më poshtë: 1.1. 20 % në orë për kujdestari; 1.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 1.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 1.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 1.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës”, si dhe konform dispozitës së nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me nr.04/L-077, ku përcaktohet se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, dhe dispozitës së nenit 245, të po këtij Ligji, ku përcaktohet se “Kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e ti”.*

Andaj në kuptim të aplikimit të dispozitave materiale të lartcekura, gjykata e vërtetojë bazën juridike dhe themelësinë të kërkesëpadisë të paditësit dhe e obligon të paditurën që t'ia kompensojë paditësit shumën e të hollave në emër të 50% të pagës bazë për punë gjatë fundjavës për vitet 2022-2023, sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase është vërtetuar se i njëjti ka punuar në vikende, në mënyrë e specifikuar si më lartë, kurse nuk është kompensuar nga e paditura, as me ditë të lira të pushimit e as me pagë shtesë prej 50 %.

Në interpretim të këtyre dispozitave ligjore dhe mënyrës së aplikimit të tyre, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev.nr. 506/2023 të datës 15.12.2023, lidhur me kompensimin e pagës shtesë për punët gjatë fund javës vlerëson se të punësuarve, si në rastin konkret paditësve, u takon paga shtesë prej 50% në orë për punën gjatë fundjavës, për shkak se një gjë e tillë parashihet me ligjin e punës, ligjin për P. dhe udhëzimin administrativ të sipërcekur. Ndërkohë që është jo kontestuese se te ne, në Republikën e Kosovës, sikundër edhe në pjesën dominuese të kontinenteve, e shtuna dhe e diela, janë përcaktuar si ditë (vikend) të fundjavës, në të cilat sipas rregullit (në parim) nuk punohet, përpos rasteve të rregulluara ndryshe me ligj, siç ka vepruar edhe Ligjdhënësi i ynë, në mënyrën e sipër përmendur.

Pretendimin e të autorizuarës se palës së paditur se kërkesa e paditësit është parashkruar, gjykata nuk e mori si të bazuar, pasi që paditësi me precizim të kërkesëpadisë kërkon kompensimin në emër të kompensimit shtesë 50 % ne ore për pune gjate fundjavës, vetëm për vitet 2021, 2022 dhe 2023, gjykata konsideron se padia në gjykate është paraqitur brenda afatit ligjore prej 3 viteve. Bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në*



*para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, pra kjo dispozitë ligjore e përcakton periudhën dhe kohën se kur fillon të rrjedhë parashkrimi, e që për gjykatën koha e rrjedhjes së parashkrimit fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës, e kurse ne këtë çështje kontestimore padia është paraqitur në gjykatë për kompensimin e të ardhurave me datë 20.12.2023, e që është brenda afatit prej 3 vitesh kur ka filluar të rrjedhë parashkrimi për vitet 2021, 2022, dhe 2023.*

Sa i përket pretendimit të autorizuarës së palës së paditur se paditësi është kompensuar për punë për fundjave pasi që sistemi P. me automatizëm bene kalkulimin dhe mjetet te gjithë punonjësve të P. se Kosovës ju dalin ne page dhe paguhen ne baza mujore, gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim, mirëpo e ka marrë në tërësi të pa bazuara, dhe është me qëllim të shmangies së përgjegjësisë së paditurës, ngase është vërtetuar se paditësi nuk është kompensuar për punë gjate vikendit, e një gjë e tillë është vërtetuar përmes ekspertizës financiare, kurse e paditura nuk ka sjellë ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën.

Gjithashtu pretendimi të autorizuarës së palës së paditur se orët e punës gjate fundjavës zyrtaret policor nuk kompensohet ngase orari i punës që i bie ne fundjave është orar i rregullte/ i zakonshëm i punës, përkatësisht orar qarkullues, ku sipas këtyre orareve zyrtareve policor me rotacion mund tu bie që të punojmë edhe gjate fundjavës, mirëpo gjykata konsideron se një pretendim i tille është i pa bazuar, pasi që punë shtese që duhet te kompensohet ka mbështetje ne dispozitën e nenit 56, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dhe dispozitën e nenit 47 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 Për P., pastaj nenin 64 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 Mbi Marrëdhënien e Punës në P. e Kosovës, andaj lidhur me këtë pjesë gjykata ka arsyetuar sa i përket bazës së kërkesëpadisë. Po ashtu, gjykata në këtë kontekst sqaron, së mënyra se si e paditura e bënë rregullimin e orarit të punës për të punësuarit të saj, është në tërësi në domenin e saj, por kjo nuk do të thotë që e njëjta të shmanget nga përgjegjësia për kompensim për punë shtesë, ngase dispozitata e mësipërme e rregullojnë në mënyrë të qartë këtë situatë, ku kushti ligjor është që i punësuarit të punoj në ditë vikendi, kurse është tërësisht jo relevante nëse ky orar i tij punës është i rregullt apo jo.

Duke ju referuar dispozitës së nenit 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës

kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t'i provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata vendimin lidhur me kamatën e gjykuar e mbështet në dispozitat e nenit 382 par.1 të LMD- se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, duke ia njohur paditësit kamatën vjetore prej 8% sipas nenit 382.2 të LMD-së *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, sipas kërkesës së saj e vetëm sa i përket kryegjësë, e të cilat vetëm sa kanë arritur për pagesë deri në përpilim të ekspertizës, kurse pjesa tjetër që nuk ka arritur për pagesë, pas përpilimit të ekspertizës e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur komfor nenin 452.1 të LPK-it së, me çka e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguan shpenzimet e procedurës dhe atë: për padi shumë prej 78 euro, për dy seanca të mbajtura nga 101 euro për seancë, taksën për padi në shumë prej 21.00 euro, për ekspertizë financiare në lartësi prej 100 euro, e në total në shumë prej 401 euro, të llogaritur sipas tarifës së OAK për vlerën e kontestit deri në 500 euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2023:290051, C.nr.4455/23, 13.03.2025**

Gjyqtari  
Vegim Maloku

---

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.